

KËRKESË PËR RISHQYRTIM

Sipas Nenit 108A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: KOMUNA GLLOGOC

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr i Prokurimit	611-19-7147-5-2-1
Nr i brendshëm	611-19-112-521

Sa i përket tenderit për

**ASFALTIMI I I RRUGËS SHTUTICË, VERBOC DHE POLLUZHË DHE
ASFALTIMI I I RRUGËS NË FSHATIN GLLANASELLE, GODANC (FAZA E DYTË)
-RITENDERIM**

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

Konz. NTSH "Dino" & VB Invest sh.p.k.

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

rr. "Vicianum", objekti refoni, kati 5, Arberi, nr.46

(Adresa)

Prishtinë

10 000

(Vendi)

(Kodi postar)

+38349/30 10 49

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Berat Hasolli

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

ybinvest19@gmail.com

(Adresa elektronike)

21.10.2019

(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)



2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për dhënie të kontratës me titull “Asfaltimi i Rrugës Shtuticë, Verboc dhe Polluzhë dhe Asfaltimi i Rrugës në Fshatin Gllanasellë, Godanc (Faza e Dytë) – Ritenderim nga Autoritet Kontraktues Komuna e Glllogocit është publikuar në KRPP. Kriteri i dhënies së tenderit ka qenë CMIMI MË I ULËT.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☒

Jo ☐

Ne kemi marrë pjesë në procesin e hapjes së tenderëve në kohën dhe vendin e caktuar nga Autoriteti Kontraktues dhe gjatë procesit të hapjes së tenderit çdo gjë ka shkuar në rregull.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Autoriteti kontraktues nuk ka vërtetuar në mënyrë të drejtë gjendjen faktike dhe ka bërë shkelje të neneve 1, 6, 59, 60 par. 1 dhe 70 të Ligjit për Prokurimin Publik.

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

Më datë 17.10.2019 GR OE "Dino" shpk dhe VB Invest shpk., ka pranuar Letrën Standarde për tenderuesin e eliminuar nga AK Komuna e Glllogocit lidhur me këtë aktivitet të prokurimit. Në këtë njoftim thuhet se këtij GR OE i mungon Lista e Stafit dhe Kontratat e Natyrës së Ngjashme. Poashtu ka pranuar edhe Njoftimin për Dhënie të Kontratës të datës 17.10.2019. Kështu, GR OE "Dino" shpk dhe VB Invest shpk., parashtrojnë këtë kërkesë për rishqyrtim ndaj të dyja këtyre dy akteve të AK Komuna e Glllogocit:

GR OE "Dino" shpk dhe VB Invest shpk., konsideron se ky konstatim i AK Komuna e Glllogocit është marrë me vërtetim të gabuar të gjendjes faktike dhe si i tillë është i pabazuar për arsyet si në vijim:

1. Konsiderojmë se konstatimi i AK Komuna e Glllogocit se GR OE "Dino" shpk dhe VB Invest shpk., nuk ka dorëzuar listën e stafit dhe Kontratat e natyrës së ngjashme nuk qëndron dhe kjo dëshmohet me disa prova dhe argumente si në vijim.
2. Fillimisht kur ky GR OE ka ngarkuar në sistemin elektronik të e-prokurimit dosjen tij të tenderit, i njëjti ka ngarkuar/dorëzuar dhe Listën e Stafit dhe Kontratat e Natyrës së Ngjashme dhe kjo dëshmohet nga ekstrakti elektronik i gjeneruar automatikisht ku shkruan Lista e Dokumente të tenderit mbështetëse, ku në numër 5 dhe 9 shkruan se është ngarkuar dokumenti i titulluar "Stafi.pdf" dhe "Lista e Punëve të Kryera & Referenca.pdf". Pra, në këtë ekstrakt të gjeneruar automatikisht nga e-prokurimi, shkruan qartë se cilat dokumente janë ngarkuar së bashku me dosjen e tenderit, e ku këtu shkruan qartë se është dorëzuar edhe LISTA E STAFIT me numër rendor 5 dhe LISTA E PUNËVE TË KRYERA DHE REFERENCA.PDF me numër rendor 9.

PROVË: Ekstrakti i gjeneruar automatikisht nga e-prokurimi me rastin e ngarkimit/dorëzimit të dosjes së tenderit.

3. Kjo provë nuk ka mundur të ndryshohet në asnjë mënyrë nga ana e OE "Dino" shpk dhe

VB Invest shpk., pasi që sic thamë në momentin kur është ngarkuar dosjes e tenderit në e-prokurim është gjeneruar/formuar automatikisht ky ekstrakt, ku shkruan saktë se janë dorëzuar edhe këto dokumente.

4. Më tutje, bashkangjitur gjeni si provë materiale edhe Listën e Stafit dhe Listën e Punëve të Kryera & Referencat, ku mund të gjeni të gjitha dëshmitë-kontratat e të gjithë stafit gjithësesj 40 faqe dhe Listën e Punëve të Kryera dhe Referencat për punë të ngjashme gjithësesj 26 faqe.

PROVË: Lista e Stafit (Kontratat) dhe Lista e Punëve të Kreyra.

5. Duke qenë se "Dino" shpk dhe VB Invest shpk., ka dorëzuar këto dokumente atëherë AK Komuna e Glllogocit është dashur që në përputhje 72 të LPP-së i cili përcakton se ***"Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji."*** të kërkoj sqarime për të qartësuar se çka nënkupton doza 1mg/1ml, e jo me automatizëm të konsideroj se ka këto dokumente nëse ka konsideruar se të njëjtat nuk i plotësojnë kërkesat e tenderit, mirëpo nuk ka mundur në asnjë rrethanë të thotë se nuk janë dorëzuar këto dokumente.
6. Mos kërkimi i këtyre sqarimeve nga OE nga ana e AK Komuna e Glllogocit, ndikon që buxheti i republikës së Kosovës, në këtë rast i Komunës së Glllogocit, për këta aktivitet të prokurimit të dëmtohet mbi 13,000.00 Euro, pasi që OE i rekomanduar për kontratë "Valdrini" është më i shtrenjtë se OE "Dino" shpk dhe VB Invest shpk.,.
7. AK Komuna e Glllogocit me këtë veprim, duke e shpallur fitues OE "Valdrini" SHPK ka vepruar në kundërshtim me dispozitën e nenit 1 par. 1 të Ligjit për Prokurimin Publik ku përcaktohet: ***"1. Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla."***
8. Pra, AK ka vepruar së pari në kundërshtim me qëllimin e Ligjit për Prokurimin Publik, ligj ky i cili rregullon në tërësi procedurën e prokurimit të Autoriteteve Kontraktuese, respektivisht menaxhimin e fondeve publike.
9. Më tutje, AK ka vepruar në kundërshtim edhe me nenin 6 par. 1 të LPP-së, ku përcaktohet: ***"1. Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit."*** Kjo pasi që siç theksuam OE "Valdrini" i cili është shpallur fitues është OE më i shtrenjtë se OE "Dino" shpk dhe VB Invest shpk. Ky veprim i AK përbën keqpërdorim të fondeve publike, pasi që qëllim i Ligjit për Prokurimin Publik dhe i aktiviteve të prokurimit publik është që të arrihet e mira e përgjithshme publike me fonde sa më të ulëta. E mirë e përgjithshme publike me shpenzimin e sa më pak fondeve publike në rastin tonë do të arrihej nëse ky aktivitet i prokurimit- kjo kontratë do t'i jepej OE "Dino" shpk dhe VB Invest shpk., i cili nëse shikohet procesverbali i hapjes së dosjes së tenderit shihet se i njëjti është OE me çmimin më të ulët dhe kështu do t'i kurseheshin buxhetit të shtetit rreth 13,000.00 Euro.
10. AK Komuna e Glllogocit ka vepruar në kundërshtim edhe me nenin 59 par. 1 të LPP-së, ku përcaktohet se: ***"Autoriteti kontraktues do të themeloj një Komision Vlerësues për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave."*** AK ka vepruar në kundërshtim me këtë dispozitë ligjore për faktin se e njëjta natyrisht se ka formuar komision vlerësues për ofertat, mirëpo ky komision siç shihet nuk e ka kryer siç duhet punën e tij, pasi që nuk ka bërë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e duhur të ofertave, respektivisht të

ofertës së "Dino" shpk dhe VB Invest shpk., pasi që sikur ta bënte një vlerësim të duhur të këtij OE, atëherë duke qenë se i njëjti është i përgjegjshëm (e që vërtetohet me provat e lartcekura), i njëjti është poashtu OE me çmimin më të ulët andaj logjikisht dhe në përputhje me dosjen e tenderit dhe dispozitat e LPP-së është dashur të shpallet fitues për këtë aktivitet të prokurimit.

11. AK përveç që nuk ka respektuar kriterin e dhënies së tenderi sipas Dosjes së Tenderit, e që ka qenë "Çmimi më i ulët" nuk ka respektuar, respektivisht ka cenuar edhe dispozitën e neni 60 par. 1 nën par. 1.1 të LPP-së, ku përcaktohet: **"Autoriteti kontraktues do t'ia jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar ose: 1.1 tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët;"**. Siç tani më u theksua AK nuk i ka dhënë tenderin OE "Dino" shpk dhe VB Invest shpk., si OE me çmimin më të ulët por i ka dhënë një OE i cili është më i shtrenjtë.
12. Për këto arsye GR OE "Dino" shpk dhe VB Invest shpk., i propozon AK Komunës së Gllogocit, që pas pranimi të kësaj kërkesë për rishqyrtim dhe vlerësimit të provave të bashkangjitura të marrë këtë:

AKTVENDIM

APROVOHET në tërësi si e bazuar ankesa e GR OE "Dino" shpk dhe VB Invest shpk., e parashtruar kundër Njoftimit për tenderuesin e Eliminuar të datës 17.10.2019 dhe **ANULOHET** Njoftimi për Tenderuesin e Eliminuar i datës 17.10.2019 dhe Njoftimi për dhënie të Kontratës i datës 17.10.2019, ashtu që procedura për aktivitetin e prokurimit 611 191 12 521 me titull "Afaltimi i rrugës Shtuticë, Verboc dhe Polluzhë dhe Asfaltimi i rrugës në fshatin Gllanasellë, Godancë (Faza e Dytë) – Ritenderim", **kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje ashtu që në procedurë të rishqyrtimit dhe rivendosjes shpallet fitues GR OE "Dino" shpk dhe VB Invest shpk., si OE i përgjegjshëm dhe me çmimin më të ulët.**

Prishtinë, 21.10.2019

GR OE "Dino" shpk dhe VB Invest shpk.,

(NENSHKRIMI DHE VULA)



8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Konsiderojmë se shkeljet e cekura më lartë kanë shkaktuar humbje të konsiderueshme materiale, kjo nga shkak se kemi humbje materiale lidhur me kostot që kanë të bëjnë me përgatitjen e ofertave. Kemi po ashtu humbje të konsiderueshme edhe sa i përket taksave të cilat jemi obliguar që t'i paguajmë për të siguruar garancionin bankar për sigurimin e tenderit në të gjitha rastet e tenderimit të kësaj kontrate si dhe shpenzimet që kanë të bëjnë me përgatitjen e kërkesës për rishqyrtim.

9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.

- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.*

NJOFTIM PËR KONTRATË

Retender

☒ **PUNË**☐ **FURNIZIM**☐ **SHËRBIME**

Sipas Nenit 40të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Data e përgatitjes së njoftimit: **19.09.2019**

Nr i Prokurimit	611-19-7147-5-2-1
Nr i brendshëm	611-19-112-521

Ky njoftim është përgatitur në GJUHËT:

Shqip



Serbisht



Anglisht



NENI I: AUTORITETI KONTRAKTUES

I.1) EMRI DHE ADRESA E AUTORITETIT KONTRAKTUES (AK)

Emri zyrtar: KOMUNA GLLOGOC		
Adresa Postare: RR. FEHMI LLADROVCI		
Qyteti: GLLOGOC	Kodi postar: 13000	Vendi: Kosovë
Personi kontaktues: MENSUR GLLAREVA		Telefoni: 038-200-40-811
Email: mensur.gllareva@rks-gov.net		Faksi:
Adresa e Internetit (nëse aplikohet): https://kk.rks-gov.net		

Po



Jo



Kontrata përshinë prokurimin e përbashkët

Po



Jo



Kontrata shpërblehet nga Agjencia Qendrore e Prokurimit

Nëse po, specifiko identitetin e të gjithë Autoriteteve Kontraktuese që kanë të drejtë të bëjnë porosi nën termet e kontratës ose referoju një Aneksi:

NENI II: LËNDA E KONTRATËS

II.1) PËRSHKRIMI

II.1.1) Titulli i kontratës i dhënë nga autoriteti kontraktues: ASFALTIMI I I RRUGËS SHTUTICË,VERBOC DHE POLLUZHË DHE ASFALTIMI I RRUGËS NË FSHATIN GLLANASELLE,GODANC (FAZA E DYTË) -RITENDERIM		
II.1.2) Lloji i kontratës dhe lokacioni i punëve, vendi i dorëzimit apo realizimit <i>(Zgjidhni vetëm një kategori - punë, furnizime apo shërbime – e cila korrespondon më së shumti me objektin specifik të kontratës suaj)</i>		
☒ Punë	☐ Furnizime	☐ Shërbime
☒ Ekzekutim ☐ Plani dhe ekzekutimi ☐ Realizimi, në çfarëdo mënyre, të punës, përgjegjës me kërkesa	☐ Blerja ☐ Qira financiare (lizing) ☐ Qira ☐ Blerje me këste ☐ Një kombinim i këtyre	
Vendi apo vendndodhja kryesore e punëve/kryesor i dorëzimit/ kryesor i realizimit ASFALTIMI I I RRUGËS SHTUTICË,VERBOC DHE POLLUZHË DHE ASFALTIMI I RRUGËS NË FSHATIN GLLANASELLE,GODANC (FAZA E DYTË)		
II.1.3) Njoftimi përfshinë Krijimin e kontratës publike kornizë ☐		
II.1.4) Informacionet e marrëveshjes kornizë (nëse aplikohet): Kontrate publike kornizë me një operator ☐ Kontrate publike kornizë me disa operator ☐ Ekzekutimi i kontratës: Thirrje/Porosi ☐ Kontrata ndihmëse/Mini-konkurencë ☐ Kohëzgjatja e kontratës publike kornizë: në muaj		

II.1.5) Përshkrim i shkurtër i lëndës së kontratës

Lënda e kontratës ka të bëjë Me punë përgatitore, punë të gërmimit, transportit të materialeve dhe të ngjashme, punë ndërtimore dhe punë të asfaltimit, sipas kushteve dhe specifikave teknike të dhëna në dosjen e tenderit.

II.1.6) Klasifikimi i Fjalorit të Përgjithshëm të Prokurimit (FPP):

45000000-7

II.1.7) Variantet pranohen

Po ☐ Jo ☒

II.1.8) Ndarja në Pjesë

Po ☐ Jo ☒

Nëse *po*, tenderët mund të dorëzohen për (shënoni vetëm një kuti)

☐ vetëm një pjesë ☐ Të gjitha pjesët

II.1.9) Informacione lidhur me pjesët (nëse aplikohen)

Nr. i pjesës	Emërtimi i grupit	Përshkrimi i shkurtër

Numri maksimal i Pjesëveqë do të mund të shpërblehet tek një tenderues është:

II.1.10) Vlera e parashikuar e kontratës: 156.507,28**II.2) SASIA APO FUSHËVEPRIMI I KONTRATËS**

Sasia apo fushëveprimi i përgjithshëm (përfshirë të gjitha pjesët dhe opsionet nëse aplikohen)
ASFALTIMI I I RRUGËS SHTUTICË,VERBOC DHE POLLUZHË DHE ASFALTIMI I
RRUGËS NË FSHATIN GLLANASELLE,GODANC (FAZA E DYTË) ASFALTIMI I RRUGËS
NË FSHATIN GLLANASELLE,GODANC (FAZA E DYTË) SEGMENTI I PARE L= 320.00m'
SEGMENTI I DYTE L= 400.00m' SEGMENTI I TRETË L= 250.00m' SEGMENTI I IV
L= 300.00m' ASFALTIMI I I RRUGËS SHTUTICË,VERBOC DHE POLLUZHË SEGMENTI I
PARE L= 400.00m' SEGMENTI I DYTE L= 165.00m'

II.3) KOHËZGJATJA E KONTRATËS APO AFATET KOHORE PËR PËRFUNDIM

Kohëzgjatja në muaj apo ditë 40 (nga dhënia e kontratës)
apo
Fillimi
Përfundimi

NENI III: INFORMACIONET LIGJORE, EKONOMIKE, FINANCIARE DHE TEKNIKE**III.1) KUSHTET NË LIDHJE ME KONTRATËN**

III.1.1) Siguria e kërkuar e ekzekutimit Po ☒ Jo ☐	
<i>Nëse po</i> , vlera e sigurisë së ekzekutimit EUR ose 10% % e vlerës së kontratës	
III.1.2) Forma ligjore që do të merret përmes grupit të operatorëve ekonomik të cilëve do t'u jepet kontrata (nëse aplikohet):	
III.1.3) Kushtet e tjera të veçanta me të cilat ka të bëjë ekzekutimi i kontratës Po ☐ Jo ☒	
<i>Nëse po</i> , përshkrimi i kushteve të veçanta	

III.2) KUSHTET PËR PJESËMARRJE

III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë: 1. Kërkesat përshtatshmerisë Konform Ligjit mbi Prokurimin Publik Ligjit Nr. 04 L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04 L-237, ligjin Nr. 05 L-068 dhe ligjin Nr. 05 L-092, përkatësisht Nenit 65 pika 1,2,3,4, 4.9 dhe 5. 2. Një vërtetim i leshuar nga administrata tatimore e vendit të themelimit 3. Një vërtetim i leshuar nga gjykata kompetente – ekonomike 4. Një vërtetim i leshuar në emër të OE se i ka të kryera pagesat mbi tatimin në pronë apo vërtetim që nuk është i ngarkuar.	<i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i> 1. Deklaratat nën betim se operatori ekonomik përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë Ligjit mbi Prokurimin Publik Ligjit Nr. 04 L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04 L-237, ligjin Nr. 05 L-068 dhe ligjin Nr. 05 L-092, siç është e cekur në Pjesën, do të dorëzohen në formë të Aneksit të gjithë pjesëmarrësit - origjinal. 2. Një vërtetim i leshuar nga administrata tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve jo me te vjeter se 90 dite (vetem per OE fitues) - kopje. 3. Një vërtetim i leshuar nga gjykata kompetente – ekonomike apo autoritetet administrative të vendit të themelimit të tenderuesit (vetem per OE fitues) – origjinal apo e noterizuar. 4. Një vërtetim i leshuar në emër të OE se i ka të kryera pagesat mbi tatimin në pronë apo vërtetim që nuk është i ngarkuar - fituesi.- kopje
III.2.2) Përshtatshmëria profesionale: 1. Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit; 2. Rexhistrimi i numrit fiskal 3. Rexhistrimi në TVSH	<i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i> 1. Një dokument i leshuar nga autoriteti përkatës publik në vendin e themelimit të operatorit ekonomik me të cilin evidentohet regjistrimi i operatorit ekonomik në atë vend (Kopja e certifikatës së biznesit); 2. Kopja e numrit fiskal 3. Kopje e Rexhistritimit në TVSH
III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar: N A	<i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i> N A
III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:	<i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i>

a) Të paraqitët stafi që do të angazhohet në këtë projekt, të cilët drejtpërdrejtë janë përgjegjës në ekzekutimin e punëve dhe në përgjithësi të projektit duke përfshirë edhe stafin profesional. Stafi i mesëm që do të kyqet në projekt – minimum 6 punonjës, Menaxheri i projektit të jetë inxhinier ose bachelor i ndertimtaris drejtimi konstruktiv me diplomë i caktuar me një vendim, CVI-ja)	Lista e stafit – Origjinal - Për të gjitha kërkesat rreth stafit duhet të ofrohen dëshmitë në kopje, për stafin profesional (inxhinierin),kontrata ose marrëveshja paraprake për angazhimin e Tijë në këtë projekt, kopja e Diplomës dhe CVI-ja - kopje . Për stafin e mesëm kontratat -kopje.
b) Të paraqitën paisjet raportet për mjetet – stabilimentet që janë dispozicionin tuaj për realizimin e projektit. (Paisje te domosdoshme) Një eskavator gërmues dhe ngarkues; dy kamion transporti të materialit të kapacitetit min 8-10 ton; një cilindër ngjeshës tamponi dhe një rrafshues.Bazë për prodhim të asfaltit dhe zhavorit ose kontratë për furnizim me asfalt dhe zhavorit.	Lista e paisjeve – Origjinal - Për të gjitha kërkesat rreth paisjeve duhet të ofrohen dëshmitë në kopje deshmi (kopjet e librezave ose fatura ose DUD-i etj, që kompania i ka ne pronësi ose kontratë mbi shfrytëzimin e tyre me qera), kopje të kontratave për furnizim me asfalt dhe zhavor të bashkangjitura me qertifikatën e biznesit, nr. fiskal, ndërsa për bazë të asfaltit dhe zhavor Licencë ose Leje të lëshuar nga Komisioni i Minierave - kopje).
c) Të paraqitën kontratat e punëve të ngjajshme në tri vitet e fundit nga dita e Publikimit te Njoftimit per Kontrat min. 100,000.00 € .	Lista e kontratave – origjinal, të natyres se ngjajshme ne 3 vitet e fundit te bashkangjiura me kopjet e kontratave , referencave ose proceseve, raporteve te pranimeve ose te ngjajshme, ku identifikohet qarte, shuma, nr. i prokurimit, viti, titulli etj) nga institucionet publike ose proceset e pranimeve nga OE privat.
d) Vendim mbi caktimin e Menaxherit	Vendim mbi caktimin e Menaxherit te projektit – origjinal.

III.3) KUSHTET SPECIFIKE PËR KONTRATAT E SHËRBIMEVE

Po ☐ Jo ☐ III.3.1)Ekzekutimi i shërbimeve i rezervuar për një profesion të caktuar <i>Nëse po</i> , referenca për ligjin, rregulloren apo dispozitën administrative përkatëse
III.3.2 Personat ligjor duhet të tregojnë emrat e kualifikimeve profesionale të personelit përgjegjës për ekzekutimin e shërbimeve Po ☐ Jo ☐

NENI IV: PROCEDURA

IV.1) LLOJI I PROCEDURËS

IV.1.1) Lloji i procedurës
☒ E hapur
☐ E kufizuar
☐ Konkurruese me negociata
☐ Kuotim i Çmimit
IV.1.2)Kufizime në numrin e operatorëve të cilët do të ftohen për tenderim (<i>procedurë e kufizuar apo konkurruese me negociata</i>) Në bazë të aplikacioneve të pranuar, më së shumti 6 kandidat do të ftohen për të dorëzuar tenderët e

detajuar të kësaj kontrate. Nëse më shumë se 6 kandidat të përshtatshëm i plotësojnë kriteret e mësipërme të përzgjedhjes, përparësitë dhe dobësitë relevante të aplikacioneve të këtyre kandidatëve do të ri-ekzaminohen për të identifikuar gjashtë aplikacionet më të mira për procedurën e tenderit. Të vetmit faktorë të cilët do të mirren parasysh gjatë këtij ri-ekzaminimi janë:

IV.1.3) Reduktimi i numrit të operatorëve gjatë negociatave (procedurë konkurruese me negociata)

Udhëheq negociatat në faza të njëpasnjëshme

Po ☐ Jo ☐

në mënyrë që të zvogëlohet numri i tenderëve të negociuar

Autoritetet kontraktuese mund të shpërblejnë kontratat në bazë të tenderëve fillestarë pa negociata

Po ☐ Jo ☐

IV.1.4 Numri minimal i kandidateve të cilët do të ftohen që të dorëzojnë Tenderët fillestar është:

IV.1.5. Informata në lidhje me ankandin elektronik

Do të përdoret ankandi elektronik: Po ☐ Jo ☒

Informata shtese në lidhje me ankandin elektronik:

IV.2) KRITERET E DHËNIES

☒ Çmimi më i ulët

ose

☐ Tenderi ekonomikisht më i favorshëm në drejtim të

IV.3) INFORMACIONET ADMINISTRATIVE

IV.3.1) Publikimet paraprake në lidhje me kontratën e njëjtë

Po ☐ Jo ☒

Nëse po,

Njoftim paraprak: i

Publikime tjera (nëse aplikohen):

i

i

Po ☐ Jo ☒

Dokumentet me pages

Nëse po, çmimi EUR

Kushtet dhe metoda e pagesës:

IV.3.2) Afati i fundit për pranim të tenderëve / aplikacioneve: data 07.10.2019 koha 14:00:00 vendi VETEM NE MENYRE ELEKTRONIKE
IV.3.3) Afati kohor për dorëzimin e tenderëve / aplikacioneve është shkurtuar: ☒ Po ☐ Jo Nëse po, jep arsyetim PER SHKAK TE RITENDERIMIT
IV.3.4) A është e nevojshme siguria e tenderit: Po ☒ Jo ☐ Nëse po, vlera e sigurisë së tenderit 1500 Vlefshmëria e sigurisë së tenderit në ditë 90 apo muaj
IV.3.5) Periudha e vlefshmërisë së tenderit: Deri më: data: ditët 60 apo muajt
IV.3.6) Takimi për hapjen e tenderëve: data 07.10.2019 koha 14:00:00 vendi ZYRA E PROKURIMIT KATI I DYTE

NENI V: INFORMACIONET PLOTËSUESE

V.1) ANKESAT

Çdo palë e interesuar mund të bëjë ankesë pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 në adresën e specifikuar në Nenin I të këtij Njoftimi për kontratë.
--

V.2) INFORMACIONET SHITESË

Shënim: operatorët ekonomik do të kenë të drejtë të dorëzojnë tenderin, kërkesën për pjesëmarrje dhe dokumentet e tjera të nevojshme apo dosjet të cilat u lejohen gjatë kryerjes së një aktiviteti të prokurimit në gjuhën Shqipe, Serbe dhe Angleze. <i>Shto informacione tjera: (si konferenca para-ofertuese, vizita në punishte etj)</i> OFERTAT DORZOHEN VETEM NE MENYRE ELEKTRONIKE ASFALTIMI I I RRUGËS SHTUTICË,VERBOC DHE POLLUZHË DHE ASFALTIMI I RRUGËS NË FSHATIN GLLANASELLE,GODANC (FAZA E DYTË) ASFALTIMI I RRUGËS NË FSHATIN GLLANASELLE,GODANC (FAZA E DYTË) SEGMENTI I PARE L= 320.00m' SEGMENTI I DYTE L= 400.00m' SEGMENTI I TRETË L= 250.00m' SEGMENTI I IV L= 300.00m' vlera e parashikuar 120,327.28€ ASFALTIMI I I RRUGËS SHTUTICË,VERBOC DHE POLLUZHË SEGMENTI I PARE L= 400.00m' SEGMENTI I DYTE L= 165.00m' vlera e parashikuar 36,180.00€

PROCESVERBALI I HAPJES SË TENDERIT / MINUTES OF TENDER OPENING / ZAPISNIK OTVARANJA TENDERA

Numri i prokurimit Procurement number Broj nabavke:	611-19-7147-5-2-1	Titulli i Kontratës Contract Title Naslov ugovoru	ASFALTIMI I I RRUGËS SHUTTICË, VERBOC DHE POLLUZHË DHE ASFALTIMI I RRUGËS NË FSHATIN GILLANASELL, GODANC (FAZA E DYTË) - RITENDERIM
Numri i brendshëm Internal No Interni broj	611-19-112-521		

Data e lëshimit Date of issue Datum izdavanja	Data e mbylljes Closing date Datum zatvaranja & Čas	Data e hapjes & Ora Opening date & time Datum Otvaranja & Čas	Vendi Place Mesto	Nr. i tenderëve të pranuar No. of Received Tenders Br. Primljenih Tendera
07.10.2019	07.10.2019, 14:00:00	07.10.2019, 14:00:00	ZYRA E PROKURIMIT KATI I DYTË	6

Nr. Br.	Tenderesi Tenderer Tenderer	Kodi i tenderit Tender label /code Oznaka ponude	Pjesë Lot Lot	e-tenderit e-tender e-ponuda	Çmimi Price Cena €	Çmimi (me TVSh) Price (with VAT) Cena (sa PDV) €	Ndryshtimi/plotësimi Supplement/Amendment Dpuna/Izmjena
1.	N.N.T. " Korabi ", ÇIKATOVË E VJETËR - . QIKATOVË E VJETËR	44/2006	ASFALTIMI I I RRUGËS SHUTTICË, VE RBOC DHE POLLUZHË DHE ASFALTIMI I RRUGËS NË FSHATIN GILLANASELL E, GODANC (FAZA E DYTË) -RITENDERIM	PO	108219,64	127699,18	JO
2.	N.N.T. Milazim Shala, KRAJKOVË, 13000, DRENAS	2019	ASFALTIMI I I RRUGËS SHUTTICË, VE RBOC DHE POLLUZHË	PO	116958,13	138010,59	JO

			DHE ASFALTIMI I RRUGËS NË FSHATIN GLANASELL E, GODANC (FAZA E DYTË) -RTENDERIM				
3.	IBRAHIM KURRUMELI B.L. Gllanasellë, 13000. Drenas	49/2019	ASFALTIMI I I RRUGËS SHUTITÇË, VE RBOC DHE POLLUZHË DHE ASFALTIMI I RRUGËS NË FSHATIN GLANASELL E, GODANC (FAZA E DYTË) -RTENDERIM	PO	116881,36	137920,00	JO
4.	Valdriini sh.p.k.FEHMI LLADROVCI BLOKU 7 BANESA 4, 13000. GLOGOC	32/2019	ASFALTIMI I I RRUGËS SHUTITÇË, VE RBOC DHE POLLUZHË DHE ASFALTIMI I RRUGËS NË FSHATIN GLANASELL E, GODANC (FAZA E DYTË) -RTENDERIM	PO	113362,72	133768,00	JO
5.	Grup i Operatorëve Ekonomik N.T.SH. Dino Sh.p.k.; VB INVEST SH.P.K., Magjistratja Prishtine-	7147-521	ASFALTIMI I I RRUGËS SHUTITÇË, VE RBOC DHE POLLUZHË	PO	102390,73	120821,06	JO

	Ferizaj. 14000. KONJUH		DHE ASFALTIMI I RRUGËS NË FSHATIN GLLANASELL E, GODANC (FAZA E DYTË) -RITENDERIM				
